



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
Këshilli Bashkiak Vlorë



**Organizata Një Zë I Barabartë
Rom dhe Egjiptian Në Komunitetin
Vlonjat**

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

Sot me datën 3.10.2016 lidhet marrëveshja e bashkëpunimit midis:

Organizata Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian në Komunitetin Vlonjat referohet si Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian me seli në Vlorë, përfaqësuar nga Drejtoria Ekzekutive **Znj. Rozina Kormuzi**.

Dhe

Këshillit Bashkiak Vlorë, e përfaqësuar nga kryetarja e saj **Znj. Vojsava Shkurtaj**.

Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian, e afirmuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të Komuniteteve Romë dhe Egjiptian, e legjitimuar me vendimin e Gjykatës nr.5165 datë. 6/10/2015. Fokusi i organizatës është më zhvilloi aktivitete me fokus mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut për komunitet të cilat kjo organizatë përfaqëson dhe mbështetje të vazhdueshme për evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave që hasin familjet e komuniteteve që përfaqësojnë.

Gjatë kontakteve dhe shkëmbimeve të ndërsjella nga të dyja palët, është vlerësuar ekspertiza e secilës palë dhe është parë e domosdoshme vendosja e një bashkëpunimi mes tyre, me qëllim mbështetjen e angazhimit që të rinjtë aktivistë të organizatës kanë marrë për përmirësimin e situatës së komunitetit të tyre.

Objektivi i kësaj marrëveshjeje do të jetë shkëmbimi i informacionit, mbështetje dhe përfshirje e grupit aktivist të të rinjve të Organizatës Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian në Mbledhjet e Këshillit Bashkiak si dhe duke u dhënë mundësinë atyre të jenë pjesë e diskutimeve që do të zhvillohen pranë Komisioneve të Këshillit Bashkiak.

Marrëveshja do të shtrihet gjatë periudhës *Shtator 2016 deri në Shtator 2020*.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Këshilli Bashkiak Vlorë dhe Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian marrin përsipër si më poshtë vijon:



Këshilli Bashkiak Vlorë merr përsipër:

1. Të lehtësoi praninë e grupit të aktivistëve të rinj të organizatës Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian në bazë dhe të Drejtës që u jep ligji për të gëzuar të Drejtën e Pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vlorë.
2. Të lejojë praninë e grupit të aktivistëve të rinj të organizatës Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian në mbledhjet e Komisioneve pranë Këshillit Bashkiak Vlorë.
3. Tu lejojë të rinjve të grupit të aktivistëve të organizatës Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian diskutimin e prioriteteve që këta të rinj kanë nxjerr lidhur me përmirësimin e situatës së komunitetit të tyre me anëtarët e Këshillit Bashkiak pranë komisioneve të Këshillit Bashkiak.
4. Tu ofrohet të rinjve Informacioni I Nevojshëm në bazë dhe të Drejtës që u jep ligji për të Drejtën e Informimit për çështje të ndryshme që ata do ti drejtohen Këshillit Bashkiak.

Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian përsipër:

1. Të informojë dhe ti vendosi në dispozicion Këshillit Bashkiak Vlorë një informacion të plotë lidhur me Problematikat që shqetëson komunitetin Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Vlorës.
2. Të jetë pjesë e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Pjesë e diskutimeve në proceset e Buxhetimit me pjesëmarrje që organizohen nga ky institucion.

“Organizata Një Zë I Barabartë Rom dhe Egjiptian në Komunitetin Vlonjat” dhe Këshilli Bashkiak Vlorë do të udhëhiqen nga interesi i target grupeve me të cilët punojnë, me qëllim që të lehtësojnë aksesin e tyre pranë shërbimeve përkatëse dhe do të angazhohen gjithashtu në hartimin dhe implementimin e programeve dhe iniciativave të përbashkëta në fushën e mbështetjes për rastet e paraqitura nga grupi I aktivistëve.

Për Këshillin Bashkiak Vlorë

Znj, Vojsava Shkurtaj
Kryetare

Për Një Zë i Barabartë Rom dhe Egjiptian

znj. Rozina Kormuzi
Drejtoresh Ekzekutive

Vlorë, me 3 / 10 / 2016

